

## Falsifikimi i 97-tës

[Sot, 25.3.2006, botuar me titullin “Blendi Fevziu falsifikon historinë e vitit ’97”, pa miratimin tim]

TV Klan, në emisionin Opinion të para pak ditëve, bëri një historik të pavërtetë të ngjarjeve të viteve 96-97, kur shteti shqiptar u shkatërrua tërësisht. Emisioni na kujtoi falsifikimet e periudhës komuniste, kur deri edhe fotografitë historike ndryshoheshin, duke hequr e zëvendësuar fytyrat e personave. E pavërteta më efikase është kur thuhet shumë të vërteta që i di kushdo, dhe gënjehet për vetëm “pak gjëra”, për ato që janë kryesoret. Këtë rrugë ndoqi edhe Opinioni: gënjeu për kryesoret, rolin dhe përgjegjësinë e presidentit të kohës, të ministrit të financave të kohës etj.

I interesuar kryesor për këtë falsifikim të historisë, është kryeministri aktual, i cili ishte presidenti i vendit në vitin 96-97, njeriu i plotfuqishëm i Shqipërisë, kur ajo ishte pothuaj një republikë presidenciale; kur presidenti ishte praktikisht edhe kryeministri; nga ai vareshin praktikisht prokuroria, SHIK, gjykatat etj.; kur presidenti ishte praktikisht edhe kryetari i PD-së.

Po bëhet shumë urgjente për masmediat aktuale, t’u kujtojmë sa vijon: “Mos u pajto me gënjeshtëri, as atëherë kur të detyron shteti,”-thoshte Ajnshtani (fizikani nobelist).

Historia shërben për orientim të drejtë në të sotmen, prandaj po mundohemi të pastrojmë dy nga të pavërtetat që u hodhën në publik.

**E pavërteta e parë**, ajo kryesorja, është fshehja e rolit të presidentit të kohës, në rritjen e pamase të piramidave, pra praktikisht në krijimin e tyre. Edhe vetë Opinion i TV Klan, dikur shpjegonte se si fajdet u patën përdorur pa mëshirë, nga presidenti i vendit, për të krijuar përshtypjen e mirëqenies masive, që shqiptarët të votonin për PD-në në zgjedhjet lokale të vitit 1996. Njerëzit duhet të votonin vetë kësaj radhe, sepse ishte një kohë kur nuk bëheshin dot më hile direkt në kutitë e votimit, sepse do të monitoroheshin intensivisht nga ndërkombëtarët: ishte qelbur me vjedhjet e votave në maj të 1996! Tregonte dikur Opinioni, edhe sesi presidenti i kohës, megjithëse më së fundi u rizgjodh president (në kohën që vendi digjesh), prapë se prapë nuk u qetësua, por e shtyu vendin më tej, drejtë luftës civile! Opinioni aktual i TV Klan, e fshehu fare këtë realitet, bile paraqiti një sajësë të paimagjinueshme: sikur presidenti i kohës ishte një figurë krejtë anësore në të gjithë atë rrënim shteti, sikur ishte një babaxhan që veçse “mbronte teorikisht nderin e parave të shqiptarëve” etj. Dakord, drejtësia akoma nuk e ka provuar rolin shkatërrimtar të z. Berisha; dakord që duhet të jemi puristë, pra duhet të kemi një “gazetari të paanshme”, po ama, fundja le të paraqitej së paku si një opsion—se mos ato që paraqiti TV Klan, ishin “të provuara nga drejtësia”? Ne jse, kjo historia me presidentin si krijues i firmave piramidale, është e rrahur shumë, prandaj nuk po e zgjasim, po kalojmë në pavërtetën tjetër.

**E pavërteta e dytë**: Ish ministri i financave i vitit 96-97, z. Bode, paskësh deklaruar se “FMN thotë se interesat e fajdeve janë shumë të larta”; paskësh qenë i pari zë brenda PD-së që paskësh qenë “kundër fajdeve”. Është e vërtetë që ai, një natë pat belbëzuar diçka të atillë me “FMN-ra”. Po, ku qëndron e pavërteta atëherë?! E pavërteta ka dy anë, atë formalen, dhe atë në përmbajtje.

**Ana formale e së pavërtetës** është se reagimi i z. Bode jepet i cunguar: jepet vetëm pjesa e parë e tij. Pjesa e dytë, që vazhdoi fill të “nesërmen e deklaratës së parë”, nuk u përmend fare nga

Opinionimi aktual. Në atë pjesën e dytë, z.Bode pat nxituar të përgënjeshtrojë, në ekranin e RTSH, pjesën e parë, po “deklaratën” e vet, duke u paraqitur i shqetësuar se “mos ishte keqkuptuar, se fajdet janë aktivitetet e lirë të tregut, se ato janë pozitive për zhvillimin e ekonomisë”, e dokra të tjera të këtij lloji. Në të PD-së na u tha, se presidenti Berisha i kishte ulur ministrit për thënien e tij “të papërgjegjshme”, e prandaj ai kishte nxituar të “sqarohet” publikisht. Pra, as formalisht z. Bode nuk ka qenë në asnjë sekondë të jetës së tij publike dhe politike në vitet 96-97, “kundër fajdeve”, por ka qenë e kundërta, një pjesmarrës konsekuent i atij mashtrimi elektoral me fajdet.

**Në përmbajtje, e pavërteta** është se Opinioni e nxorri të larë z. Bode, me gjithë se ai ka së paku përgjegjësi teknike për fajdet: sapa u bë ai ministër i financave, fajdet filluan të rriten në mënyrë eksponenciale (me disa fish) deri sa përfshinë pjesën dërmuese të popullsisë së vendit, brenda fare pak muajve (brenda 3-4 muajve, në prag të zgjedhjeve lokale të 96-tës); e kjo kur ligji shqiptar për bankat, e ndalonte qartë një aktivitet të tillë. E kjo bëhet me qëllim, sepse Opinioni i TV Klan e di mirë se ishin njerëz të tjerë ata që nga “brenda PD-së” u ngritën kundër fajdeve. Shkruesi i këtyre radhëve, ka qenë i pari nga titullarët e PD-së (ishte kryetari i komisionit parlamentar të ekonomisë dhe anëtar i kryesisë së PD-së), që u detyrua të dalë edhe publikisht kundër fajdeve, kur e pa se nuk po i ecnin përpjekjet disa mujore brenda PD-së për të parandaluar katastrofën që po vinte; prononcimi i parë publik imi, për rrezikun e fajdeve, daton më 21.11. 1996, ku krejtë qartë jepesh alarmi për rrezikun e tyre. Ja një fragment nga ai prononcim:

*“Qeveria Shqiptare e pastaj të gjithë segmentet e shtetit ...të sigurojnë që mijëra familjeve shqiptare t’u eliminohet në maksimum rreziku i rënies viktimeve e mashtrimit .... Kjo do të bënte të humbnin paratë për depozituesit dhe në raste më të rënda, edhe keqësimi të nivelit ekonomik edhe për të gjithë shqiptarët, që kanë futur lekë me fajde edhe për ata që nuk kanë futur.”* (nga diskutimi në Kuvend, botuar i plotë në gazetën Albania, të 22.11.1996).

Nejse, le të shpresojmë se do të dalin edhe shumë të tjerë që do t’i kundërvihen falsifikimeve të historisë me fajdet!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 23.3.2006